

Prishtinë
16/02/2018**Për:** Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, z.Skender Reçicën**Nga:** OJQ Germin**Tema:** Marrëveshja për sigurimet shoqërore në mes të Kosovës dhe Zvicrës

I nderuar zotëri Reçica,

Më 18 dhjetor 2017, organizata jo-qeveritare Germin, në kuadër të iniciativës *Dialogu i Strukturuar për të Drejtat e Diasporës* (www.diasporaflet.org) ka mbajtur takimin virtual (Google Hangout) me temën *Marrëveshja për Sigurimet Shoqërore në mes të Kosovës dhe Zvicrës*. Në këtë takim ishin prezent:

1. Osman Osmani, Sekretar Nacional për Migrim në Sindikatën UNIA, Zvicër.
2. Besa Baftiu, deputete nga Lëvizja Vetëvendosje dhe kryetare e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Republika e Kosovës.
3. Hilmi Gashii, Bashkëdrejtues i Regjionit Berner Oberland Sindikata UNIA, Zvicër.
4. Bahri Xhaferi, Drejtor i Departamentit të Pensioneve në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Republika e Kosovës.
5. Ruzhdi Ibrahim, ekspert i diplomuar i sigurimeve shoqërore në Zvicër.
6. Fjolla Vukshinaj, koordinatorë e programit DSDD, Germin, Republika e Kosovës.

Diskutimi u moderua nga Agim Mazreku, student i energjisë alternative në Kolegjin e Atlantikut në Main.

Marrëveshja për sigurimet shoqërore, e njohur në opinion si "marrëveshja e pensioneve" në mes të Kosovës dhe Zvicrës është preokupimi kryesor për shtetasit e Kosovës që kanë punuar në Zvicër para dhe pas ndërprerjes së zbatimit të marrëveshjes, më 1 prill 2010. Ndërprerja e zbatimit të marrëveshjes me Kosovën nga pala zvicerane, është cilësuar si një padrejtësi shumë e madhe nga shumë shtetas kosovarë me qëndrim në Zvicër dhe deputetë të Republikës së Kosovës e të Zvicrës. Ndonëse, më 1 qershor të vitit 2017 është nënshkruar marrëveshja e re nga grupet teknike e të dy shteteve, mjerisht diskriminimi ende nuk ka përfunduar. Dhjetëra mijëra shtetas nga Kosova të cilët kanë qenë të detyruar të kthehen apo kanë vendosur të kthehen në Kosovë pas veprimtarisë ekonomike për dekadave të tëra në Zvicër, ende nuk e kanë mundësinë e realizimit të përfitimeve në të cilat kanë të drejtë në rast të ndonjë rreziku social, edhe pse rregullisht kanë paguar kontributet e obligueshme në arkat e sigurimeve shoqërore.

Në rast se marrëveshje e re ratifikohet, përjashtohen nga përfitimi i merituar shumë të prekur për një periudhë gati 10 vjeçare, kontribuues në arkat e sigurimeve shoqërore të Zvicrës. Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës në vazhdimësi ka shkaktuar zemërim të aktivistëve mërgimtarë, duke dështuar të përfshijë ekspertë të diasporës si pjesëmarrës në procesin e negociatave me shtetin zviceran. Për këtë, ne po ju dërgojmë pesë (5) rekomandimet e dala nga ky diskutimin, të cilat besojmë që mund të kontribuojnë dukshëm deri në zgjidhjen e kënaqshme të kësaj çështje.

- Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Mirëqenies dhe Punës Sociale të ketë prioritet fushën e politikave sociale në lidhje me Marrëveshjen e Sigurimeve Shoqërore mes Kosovës dhe Zvicrës;
- Qeveria e Kosovës të ndërmarrë të gjithë hapat e domosdoshëm për përsheptimin e procesit të ratifikimit të marrëveshjes së arritur më 1 qershor 2017;
- Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Mirëqenies dhe Punës Sociale të ndërmarrë masa në konsolidimin e strukturave të zbatimit në Departamentin e Pensioneve si zyrë ndërlidhëse e paraparë në marrëveshjen e re me qëllim të zbatimit eficient të marrëveshjes ndërshtetërore;
- Në grupin formues ndërministrorë, Qeveria e Kosovës, respektivisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të përfshijë ekspertët shqiptarë nga Diaspora, të angazhuar rreth marrëveshjes në fjalë që nga viti 2004 dhe lobuesit dhe kontribuuesit tjerë të ngushtë nga Kosova dhe Zvicra;
- Qeveria dhe Ministritë përgjegjësi në vazhdimësi të njoftojnë të prekurit, familjarët dhe gjithë shoqërinë në lidhje me Marrëveshjen e Sigurimeve Shoqërore, dhe veçanërisht:
 1. Të njoftojë me shkresa të veçanta personale të prekurit dhe familjarët e tyre nga kjo marrëveshje;
 2. Të zhvillojnë fushatë informuese dhe vetëdijesuese mbi këtë marrëveshje duke shfrytëzuar kanalet e tyre informuese, mediat publike të Republikës së Kosovës dhe mediat tjera sociale.

Në mungesë të informimit të rregullt nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës, me mijëra të prekur dhe familjarë të tyre kanë rënë pre e spekulantëve dhe agjencive, të cilët i kanë dezinformuar ata me qëllime përfitimesh materiale, dhe deri më tani ata janë lënë vetëm dhe nuk është bërë asnjë përpjekje e vetme që të mbrohen shtetasit e prekur dhe që ky manipulim përfundimisht të ndërpritet.

Prandaj, duke marr parasysh se kjo marrëveshje e cila është jetike për shtetasit nga Kosova të cilët kanë punuar apo punojnë në Zvicër, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të tregoj një vullnet politik për ndryshimin e kësaj çështje.

Shpresojmë që pikat e përmendura më lartë do të hapin një diskutim më të gjerë rreth Marrëveshjes së Sigurimeve Shoqërore në mes të Kosovës dhe Zvicrës.

Me respekt,

Liza Gashi, Drejtoreshë e Programeve



www.diasporaflet.org